
Abuzimi me fëmijët

Arqile Kosta
2001

I Hyrje

Abuzimi me të mirurit, nënkupton veprime të qëllimshme që sjellin si rezultat dëmtimin fizik ose emocional të fëmijëve. Termi “*abuzim me të miturit*” përfshin një shkallë të gjerë sjelljesh që fillojnë që nga ndëshkimi fizik i fëmijëve nga prindërit e tyre sikurse ndodh rëndom apo nga kujdestarët e tyre të rritur (mësuesit, edukatorët dhe kujdestarët në institucionet e kujdesit për fëmijët) gjer tek neglizhimi apo injorimi i nevojave bazë të fëmijëve sikurse janë nevojat për ushqim, afinitet prindëror dhe arsimim. Ndonjëherë termi quhet edhe keqtrajtimi dhe keqrritja e fëmijëve. (Konventa për mbrojtjen e të drejtave fëmijeve)

Megjithë shtrirjen që ka koncepti dhe vështirësinë që ka matja e tij, ai tashmë është evidentuar si një problem i madh social, veçanërisht në vendet e industrializuara. Në këto vende problemi i mirërritjes së fëmijëve ka dalë nga caqet e familjes si një problem i brendshëm i saj për tu shndruar realisht në një problem të të gjithë shoqërisë. Kjo për faktin se sensibilizimi i opinionit shoqëror është bërë edhe nga njohja e satusit vulnerabël të kësaj kategorie, por edhe për shkak të ndjeshmërisë së problemeve që shqetësojnë këto shoqëri dhe fenomeneve negative që janë të lidhura dhe shkaktohen në një masë të madhe nga keqtrajtimi dhe keqrritja e fëmijëve në një shoqëri që po bëhet gjithnjë e më impersonale. Kjo sidoqoftë ndodh në të gjitha grupet e të ardhurve për shkak të lëvizjes së brendshme të popullatës, në grupet racore, fetare dhe etnike, në shoqëritë urbane dhe njëkohësisht në ato rurale. Më i theksuar dhe më i zakonshëm fenomeni është në ato grupe dhe shoqëri që ndodhen përtej caqeve të linjës së varfërisë.

Kultura të ndryshme kanë përpunuar standarde të ndryshme për të përcaktuar se çfarë do të përfshihet në termin “Abuzim me fëmijët”. Në Suedi, psh ligji ndalon çdo ndëshkim fizik tek fëmijët nga kushdo qoftë, duke përfshirë edhe të bërëtiturit apo sharjet. Ndryshe nga ky qëndrim, në disa vende të Azisë, të Afrikës apo të zonës së Karaibeve, konsiderohet si e natyrshme që prindërit të ndëshkojnë fëmijët e tyre duke i rrahur, madje edhe me shkop apo mjete të tjera të forta.

II TIPET E ABUZIMIT

Ka tipe të ndryshme të abuzimit me të miturit dhe disa nga fëmijët përjetojnë më shumë se sa një nga këto forma.

Abuzimi fizik përfshin veprimet e dhunëshme të vullnetëshme që dëmtojnë ose vrasin fëmijët. Të tilla janë shenjat e mavijosjes së pashpjegueshme, kocka të thyera ose shenja djegje tek një fëmijë mund të jenë shenja të abuzimit fizik mbi ta.

Abuzimi seksual ndodhin kur të rriturit i përdorin fëmijët për të arritur kënaqësi seksuale ose i ekspozojnë ata për dhe ndaj veprimeve seksuale. Abuzimi seksual mund të nisë me një puthje ose ledhatime të karakterit seksual dhe vazhdojnë me më tej me veprime ndërfitëse, si seksi oral ose penetrimet vaginale dhe anale.

Abuzimi emocional shkatërron vetvlerësimin e fëmijëve. Abuzime të tilla përfshijnë zakonisht abuzimet verbale tek një fëmijë në format e të bërëtiturit që shoqëron të qëlluarit me shpullë, kërcënimet dhe kritikizmin përbuzës dhe nënështrues. Tipe të tjera të abuzimit emocional me fëmijët janë mbyllja ose izolimi i

tyre psh në një dhomë, dollap, apo banjë të errët, izolimi social ose pengimi i tyre për t'u shoqëruar ose luajtur me bashkëmoshatarët e vet për kohë të caktuara apo përgjithmonë.

Më i zakonëshmi nga tipet e abuzimit me fëmijët është neglizhimi i tyre apo moskujdesi për mirërritjen e tyre. Neglizhimi fizik ka të bëjë me dështimin e prindërve apo pamundësinë e tyre ekonomike për tu siguruar fëmijëve të tyre ushqim të mjaftueshëm, veshjet e përshtatëshme, strehim dhe kujdes shëndetësor për fëmijët e tyre. Ai mund të përfshijë gjithashtu edhe mbikqyrje dhe kujdestari të pamjaftueshme dhe dështim të vazhdueshëm për të mbrojtur fëmijët nga rreziqet potenciale ose lodrat e rrezikëshme.

Neglizhimi emocional ndodh kur prindrit, të afërmit ose kujdestarët nuk ja arrijnë si duhet të njohin dhe plotësojnë nevojat bazë të fëmijës për afeksion (dhemshuri) dhe qetësi. Shëmbuj të neglizhimit emocional mund të jenë sjelljet dhe qëndrimet e ftohta, të distancuara, dhe pa dhemshuri ndaj fëmijës, duke i lënë fëmijët të jenë dëshitarë të keqtrajtimit kronik dhe të ashpra të çiftit, duke i lënë të përdorin drogën ose alkoolin apo duke i inkurajuar të përfshihen në sjellje rrugaçerie dhe qëndrime antiligjore.

Formë e neglizhimit është dështimi nga ana e prindërve, kujdestarëve të tyre apo mësuesve për të plotësuar nevojat bazë të edukimit të fëmijëve, ose për ta çuar një fëmijë në shkollë apo lejimi që ai të largohet vazhdimisht nga shkolla.

Një formë abuzimi me të miturit është edhe shfrytëzimi i punës së tyre të zezë dhe të papaguar apo detyrimi për të lypur nga ana e prindërve dhe tutorëve për ata fëmijë që janë pa familje ose janë larguar për arsye të ndryshme nga shtëpia dhe jetojnë në grupe. Kjo formë abuzimi në legjislacionet penale të mjaft vendeve përbën një shkelje të ligjit penal dhe konsiderohet krim

III Shkaqet

Shumë njerëz kanë vështirësi të kuptojnë pse një person i rritur plagos apo lëndon një fëmijë. Shpesh publiku mendon se njerzit që keqtrajtojnë dhe abuzojnë me fëmijët e tyre vuajnë nga sëmundje mendore. Kjo është e vërtetë edhe për ato raste e kultura që në traditën e tyre mund të lejojnë, të justifikojnë dhe të pranojnë si normale disa nga llojet e abuzimit psh të bërtiturit apo të goditurit me shpullë, por që nuk tolerojnë format më të rënda të keqtrajtimit sikurse përmendëm më sipër. Ato në të gjitha rastet. Studimet tregojnë se shumë pak nga njerzit që keqtrajtojnë dhe abuzojnë me fëmijët e bëjnë këtë për shkak të ndonjë sëmundje mendore. Shumica e abuzuesve i duan fëmijët e tyre apo shqetësohen për ta, por kanë prirjen psikologjike dhe kulturore të tregojnë dhe të kenë pak durim e pjekuri të personalitetit të tyre në krahasim me prindërit dhe tutorët e tjerë. Këto cilësi ja u bëjnë të vështirë kuptimin dhe marrjen me fëmijët dhe me kërkesat e tyre të rritjes që shpesh duken të çuditëshme dhe absurde. Për këtë arsye ato bëjnë të rritet mundësia për abuzime dhe keqtrajtime fizike dhe emocionale me sensin se u duhet dhënë një "mësim i mirë" si të sillen me të mëdhejtë dhe çfarë të kërkojnë prej tyre.

Sidiqoftë nuk ka një shpjegim të vetëm për keqtrajtimin e fëmijëve, psh vetëm psikologjik, vetëm social apo vetëm për shkaqe sëmundje psikike. Abuzimi dhe keqtrajtimi i fëmijëve mund të vijë si rezultat i kombinimit të një numuri kompleks faktorësh personalë, socialë e psikologjikë. Këta faktorë mund të grupohen në katër kategori kryesore: (1) transmentimi brez pas brezi i përdorimit të dhunës mbi fëmijët, (2) stresi social, (3) izolimi social dhe pjesmarrja e pakët sociale në jetën e komunitetit, psh në rastet e komuniteteve të çorganizuara dhe me aftësi të pakta vetërregullimi normativ e moral (4) struktura familjare.

A. Transmentimi i përdorimit të dhunës, si trashëgimi

Mjaft fëmijë mësojnë sjelljet e dhunëshme nga prindërit e tyre dhe pastaj kur rriten abuzojnë në këtë mënyrë tek fëmijët e tyre. Në këtë mënyrë sjelljet abuzive transmentohen nga brezi në brez. Studimet tregojnë se rreth 30 përqind e abuzimeve tek fëmijët bëhen nga prindër që e kanë provuar këtë abuzim në fëmijërinë e tyre, ndërkohë që vetëm 2 - 3 përqind e të gjithë individëve bëhen ose janë prindër që abuzojnë me fëmijët e tyre. Fëmijët që provojnë apo bien viktima të abuzimeve dhe të dhunës nga më të rriturit, mund ta adoptojnë këtë lloj sjellje si model për të ardhmen prindërore të tyre.

Megjithatë shumica e rasteve të abuzimit me fëmijët nuk ndodhun nga të rritur apo prindër që kanë këtë të shkuar abuzive apo që kanë provuar abuzime të tilla në fëmijërinë e tyre dhe nga ana tjetër nuk është e thënë që fëmijët që bien viktima të abuzimit do të bëhen patjetër të rritur që do të abuzojnë me fëmijët. Disa ekspertë të kësaj fushe mendojnë se parathënësi apo treguesi më i rëndësishëm i abuzimeve të mëvonëshme bëhet fakti nëse fëmija arrin në përfundimin se ai sillet gjithmonë gabim. Fëmijët që besojnë se sillen gjithmonë keq e gabim dhe e meritojnë keqtrajtimin e abuzimin, pra në një farë mënyre e pranojnë si të natyrshëm të rrahurin, bëhen më shpesh prindër abuzive sesa fëmijët që besojnë se prindrit e tyre e kanë gabim që i keqtrajtojnë dhe abuzojnë me ta.

B. Stresi social

Stresi që krijohet nga një numur shkaqesh të kushteve sociale rrit rrishtun që fëmijët të bien viktima e abuzimit brenda familjes. Këto kushte përfshijnë papunësinë, sëmundjet, kushtet e varfëria dhe të këqia të banimit, madhësia e familjes më tepër sesa mesatarja, lindja e një fëmije tjetër ose prania e personave të paaftë në shtëpi. Një numur i madh i rasteve të evidentuara të abuzimit dhe keqtrajtit të fëmijëve vijnë nga familje që jetojnë në varfëri. Abuzime dhe keqtrajtime vrehen edhe në familjet e mesme dhe të pasura, por ato që ndodhin në familjet e varfëria janë më mirë të evidentuara për disa arsye. Familjet e pasura e kanë më të lehtë t'i fshehin abuzimet apo të mos bien në sy, nëse kjo është e papranueshme nga normat morale dhe ligjore të shoqërisë sepse ato në përgjithësi kanë më pak kontakte me agjensitë sociale që merren me trajtimin e këtyre problemeve sesa familjet e varfëria. Nga ana tjetër punonjësit socialë, mjekët, policët dhe prokurorët që evidentojnë dhe trajtojnë fenomenin e abuzimit janë më të prirur subjektivisht të etiketojnë fëmijët nga familjet e varfëria si viktima më tepër sesa ata të familjeve të pasura.

Alkooli dhe përdorimi i drogës, të zakonëshme midis prindërve abuzivë, mund ta rëndojnë gjëndjen e tyre të stresit dhe të nxisin sjellje të dhunëshme. Po ashtu edhe disa karakteristika negative të zhvillimit të fëmijëve, si zhvillimi i vonuar mendor e fizik apo paaftësi të zhvillimit mund ta rritun stresin e prindërve dhe të shtyjnë në veprime abuzive.

C. Izolimi social dhe integrimi i pamjaftueshëm në jetën e komunitetit

Prindërit dhe kujdestarët që abuzojnë me fëmijët priren të jenë të izoluar nga shoqëria. Pak prej tyre i gjejmë si pjestarë të organizimeve komunitare apo shoqatave të ndryshme dhe shumica e tyre kanë kontakte dhe marrëdhënie të vakëta e të reduktuara me miqtë e tyre dhe të afërmit. Kjo mungesë e përfshirjes sociale i privon këta të fundit nga sistemet e përkrahjes që mund të ofrojnë ndihmë për të marrë më mirë përgjegjësitë e tyre dhe të trajtojnë me kujdesin e duhur streset që kanë në shoqëri dhe në familje. Për më tepër mungesa e kontakteve me komunitetin i bën këta prindër dhe kujdestarë të kenë më pak shanse të ndryshojnë dhe të modifikojnë në

sensin e duhur sjelljet e tyre për të qënë në konfomitet me vlerat, standartet dhe ligjet e komunitetit.

Faktorët kulturorë shpesh përcaktojnë sasinë dhe cilësinë e përkrahjes komunitare që i ofrohet dhe merr një familje. Në ato kultura ku abuzimi me fëmijët nuk përbën ndonjë problem shqetësues, në përgjithësi kjo vjen se kujdesi për fëmijët është konsideruar si një përgjegjësi e komunitetit dhe opinioni mban qëndrime ndaj kujtdo individ që nuk i përmbahet plotësisht të kësaj përgjegjësie. Kjo do të thotë se komuniteti, fqinjët, të afërmit, dhe miqtë japin ndihmën e tyre për kujdesin ndaj fëmijëve si një përgjegjësi e përbashkët kur prindërit nuk e tregojnë një vullnet të tillë ose janë të paaftë ta mbajnë një përgjegjësi të tillë.

D. Struktura familjare

Disa tipe familjesh kanë probabilitet më të madh se të tjerat të kenë rrezikun e abuzimit dhe neglizhencës ndaj fëmijëve. Psh, familjet më një prind (të divorcuar apo të vdekur) janë më të prirura të abuzojnë me fëmijët sesa ato me të dy prindërit. Një nga shkaqet është se keto familje me një prind zakonisht fitojnë më pak parë sesa ato me dy e kjo mund të ndikojë në rritjen e rrezikut për abuzime, keqtrajtime apo neglizhencë të fëmijëve. Familjet me mosmarvesheje kronike martesore apo që vuajnë nga abuzimet në çift kanë në përgjithësi shkallë më të lartë probabiliteti të abuzimit me fëmijët sesa familjet që nuk i njohin probleme të tilla. Më tej familjet në të cilat vetëm njëri nga bashkëshortët, burri ose gruaja, luajnë rol vendimtar në marrjen e vendimeve të rëndësishme—si psh ku do të jetojnë, çfarë pune do të bëjnë, sa fëmijë do të kenë dhe sa do të shpenzojnë nga të ardhurat për ushqim dhe banim—kanë probabilitet më të madh të përjetojnë edhe abuzime të llojeve të ndryshme me fëmijët në krahasim me ato familje në të cilat prindërit vendosin me mirëkuptim dhe sëbashku për këto gjëra.

IV Efektet dhe pasojat mbi fëmijët

Pasojat dhe efektet e abuzimit dhe neglizhencës ndaj fëmijëve mund të jenë shkatëruese dhe të paimagjinueshme. Dëmtimet fizike që fillojnë me mavijosjet, plagosjet nga të rrahurit dhe djegjet shkaktojnë edhe dëmtime të trurit, paaftësi të pakthyeshme madje edhe vdekjen e fëmijës. Efektet psikologjike të abuzimit dhe neglizhencës gjithashtu mund të jenë problematike për mirërritjen e fëmijëve, mund të ndikojnë në shfaqjen e vonësive mendore të pakthyeshme që mund shkaktojnë humbjen ose zvogëlimin e sensit të vlerës së vetvetes, paaftësi për të krijuar marrëdhënie me bashkëmoshatarët, zvogëlim të hapësirave të vëmendjes dhe çrregullime të të mësuarit. Në rastet më të rënda, abuzimi mund të shkaktojë çrregullime psikiatrike si psh depresione psikike, shqetësime të tepëruara ose çrregullime të identitetit social dhe veçim social, madje shtojnë edhe rrezikun për vetvrasje. Shpesh mbas abuzimit apo neglizhencës shtohen probleme të sjelljes të natyrës së shfaqes së akteve të dhunës dhe pjesmarrje në krimet që kryejnë zakonisht të rinjtë.

Fëmijët të cilët i janë nënshtruar veprimeve të abuzimit seksual, fillimisht mund të tregojnë interes të pazakontë për organet seksuale. Ata mund të demonstrojnë sjellje anormale, sipsh masturbime në publik ose shfaqje në publik të organeve të veta gjenitale. Efekte më afat gjata përfshijnë depresionet psikike, nivel të ulët të respektit për veten dhe probleme seksuale si psh shmangje apo refuzime në moshë më të madhe për kontakte seksuale edhe brenda martesore, konfuzion lidhur me natyrën biologjike e sociale të seksualitetit ose përfshirje në prostitucion të llojeve të ndryshme.

Përveç rasteve të abuzimit, sidomos të abuzimeve të rënda seksuale, të cilat paraqesin një kompleksitet problemesh që e bëjnë shpesh të vështirë apo të pamundur riaftësimin e zhdukjen e pasojave, shumivca e fëmijëve të keqtrajtuar nuk tregojnë shenja ekstreme shqetësimi e çrregullimi psikosocial dhe për këto arsye mund t'i përballojnë problemet dhe pasojat që kanë. Ka një numur faktorësh që ndihmojnë fëmijët e sulmuar nga efektet e keqtrajtimit. Në këto faktorë mund të përmendet inteligjenca e lartë që mund të ketë fëmija, arritjet e mira në procesin mësimor në shkollë, temperamentin e mirë të tij dhe sidomos pasja e marrëdhënieve të ngushta personale me miqtë, të afërmit e tjerë dhe bashkëmoshatarët.

A. Kujdesi për fëmijët viktime të abuzimit dhe keqtrajtimit

Studiuesit dhe punonjësit që merren me trajtimin dhe kujdesin e fëmijëve bien dakord përse i përket opsioneve që mund të mbahet ndaj fëmijëve që kanë qënë viktime të abuzimeve apo të neglizhencës zakonisht mund të jenë dy: (1) ndarja e fëmijëve nga prindrit e tyre abuzivë dhe dhënia në kujdestari të afërmeve të njerit nga bashkëshortët, në shtëpitë e fëmijës ose në institucione të specializuara të shtetit, (2) mbajtja e fëmijëve pranë prindërve të tyre, me kusht që familja të pranojë ndihmën sociale si këshillimin social e psikologjik, kontrollin e organeve të specializuara, ndihmë ushqimore dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor të fëmijës.

Kohët e fundit, për shkak të njëjarjeve të bujshme të keqtrajtimit dhe abuzimit me të miturit, të rrëmbimit apo shitjes së tyre për qëllime prostitucioni, përfshirja në veprime kriminale, mbyllja në shtëpi për shkak të gjakmarrjes, përdhunimit, largimet nga shkolla për të punuar nëpër rrugë si lypsa apo cigareshitës ambulante, shfrytëzimi i punës së zezë të fëmijëve etj kanë shtuar zërat për të bërë rregullime ligjore të këtij problemi të madh social edhe në shqipëri. Gjithashtu rol në këtë sensibilizim të opinionit kanë luajtur edhe konventa për të drejtat e fëmijëve dhe veprimtaria e organizmave ndërkombëtare që trajtojnë problemet e fëmijëve si dhe disa organizata joqeveritare që zhvillojnë aktivitet intensiv në këtë fushë.

Diskutimet për krijimin e gjykatave për të miturit, për trajtimet e tyre të ndryshme nga të rriturit e përfshiorë në krim, në organet vet natyrorë abuzivë mund të përballen me rreziqe. Fëmijët mund të mos e kuptojnë pse ata largohen nga familja e tyre dhe nga shtëpia për ta çuar në ndonjë institucion shtetëror të specializuar për trajtimin e këtyre lloj fëmijëve apo për ta adoptuar tek të afërmit apo në ndonjë familje tjetër me kushte më të mira jetese e mirërritjeje për ta. Fëmijët mund të mos jenë të vetdijshëm se i nënshtrohen abuzimit apo neglizhimit nga prindërit e tyre pasi mund ta shikojnë sjelljen e tyre si diçka të natyrshme dhe normale dhe për këtë arsye largimi nga shtëpia mund tu duket sikur janë ata që kanë bërë diçka të gabuar dhe për këtë po ndëshkohen. Gjithashtu, agjencitë e mirërritjes së fëmijëve shpesh kanë vështirësi për të gjetur vende të përshtatshme për të vendosur fëmijët e keqtrajtuar sepse këta fëmijë kërkojnë vazhdimisht kujdes special. Nëse ata bëhen barrë për çdo prind apo institucion që do të kujdeset, risku i abuzimit mund të jetë edhe më i madh sesa në familjen e vet biologjike.

Po ashtu ka rrezik që të mbahen këta fëmijë në shtëpitë e tyre. Kjo për arsye se shërbimet e përkrahjes sociale, konsulenca psikologjike apo edhe ndërhyrja e punonjësve të specializuar të policisë mund të mos i zgjidhin dot problemet që çojnë në abuzime, keqtrajtime dhe neglizhenca dhe për këtë arsye këta fëmijë mund t'i nënshtrohen abuzimeve të tjera më të rënda madje edhe mund të vriten. Nga një studim i kryer është vënë re se për fëmijët që janë vrarë nga prindërit ose kujdestarë e tyre 30 deri 50 përqind e tyre kanë qënë identifikuar paraprakisht si fëmijë që kanë mbetur në shtëpitë e tyre ose janë rikthyer në to pas një kohe të shkurtër largimi.

B. Parandalimi dhe programet e trajtimit

Ka mjaft tipe të programeve sociale që përdoren dhe aplikohen për të zvogëluar dhe parandaluar abuzimin, keqtrajtimet dhe neglizhencat ndaj fëmijëve. Disa nga këto programe në të cilat mund të përfshihet me shumë sukses edhe policia me personelin e vet të specializuar e të trainuar së bashku me punonjësit e agjencive të tjera të specializuara të kujdesit dhe përkrahjes sociale të fëmijëve janë psh ato që synojnë të identifikojnë prindërit me potenciale apo me rrisht të lartë abuzimi, sikurse mund të jenë nënat e reja, të vetme (që kanë fëmijë jashtë martese, të divorcuara ose të veja) dhe ato që janë për herë të parë nëna—dhe që ofrojnë trainime në aftësimin prindëror të mirërritjes të fëmijëve, këshillim, edukim dhe përkrahje sociale e psikologjike.

Shpesh punonjës socialë të trainuar posaçërisht, punonjës policie të lagjeve apo specialistë të marrëdhënieve publike apo mamitë e shtëpive të lindjes, japin një ndihmë të tillë, duke vizituar familjet në shtëpi në baza të rregullta ligjore dhe sistematike, duke inkurajuar kontaktet me komunitetin e banorëve dhe duke përcjellë njohuritë e fituara në hërbimet sociale psikologjike për mirërritjen e fëmijëve.

Disa programe që bazohen në vizitat e familjeve në shtëpi e tyre kanë treguar se janë premtuese në drejtim të reduktimit të abuzimeve dhe keqtrajtimit të fëmijëve ndërmjet familjeve me rrisht të lartë. Strategjitë më të suksesëshme parashikojnë vizita në shtëpi me programe qysh para lindjes së fëmijëve dhe që vazhdojnë deri dy a më shumë vjet.

Programe të tilla janë edhe ato që ndërmerren nga punonjësit e specializuar të policisë për trajtimin e fëmijëve që kanë probleme me ligjin. Mjaft nga problemet e grupmoshave të reja me ligjin janë të lidhura me keqsjellet e tyre apo përfshirjet në krimet e rrugës, si rrahjet, grabitjet, aktet e rrugaçerisë, vjedhje, krijimi i bandave kanë bazë reale dhe të ndjeshme tek keqrritja dhe abuzimi që kanë provuar nga prindërit e tyre apo nga neglizhenca familjare dhe sociale e treguar ndaj tyre në të kaluarën, qëndrime të cilat sikurse verifikohet nga mjaft kërkime të psikologjisë së fëmijëve rezultojnë në sjellje të paqëndrueshme dhe të dhunëshme të tyre apo për mosbindje ndaj rregullave dhe ligjeve.

Për këto arsye shkuarja në shtëpi i punonjësve të policisë të specializuar e të trainuar posaçërisht, mund të ndikojë pozitivisht si në përmirësimin gjëndjes apo në reduktimin e keqtrajtimeve ashtu edhe në rritjen e përgjegjësisë prindërore ndaj sjelleve të fëmijëve dhe rritjen e kërkesës së llogarisë për ta sikurse mund të funksionojë në rastin e prindërve që aknë pak kontroll apo treojn tolerancë të tepëruar ndaj sjelleve të papëlqyeshme të fëmijëve të tyre.

Veprime të tilla, ka mjaft gjasa të perceptohen si një përpjekje e institucioneve të shoqërisë dhe të policisë për të zgjidhur sëbashku me komunitetin të problemeve që shqetësojnë familjet e veçanta.